



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

Nr. 367 prot

Klos, më 25. 01. 2024

Lënda: Shkresë përcjellëse.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Klos

Klos

Të nderuar,

Bashkëlidhur gjeni listën emërore të familjeve për miratim nga ana juaj për Subvencionim Qiraje për vitin 2024.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

Valbona KOLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL, NDIHMËS EKONOMIKE, STREHIMIT
SOCIAL, BARASIZË GJINORE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

Nr. 367 Prot.

Klos, më 21/21/2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ Prot., Datë ___/___/2024

PËR

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËR EFEKT SUBVENCIONIMI QIRAJE”

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës; ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”; Vendimit nr.361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre i strehimit, në rastet e parashikuara në ligj dhe bashkëpunimit institucional”; Vendimit nr. 362, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”; Vendimit nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; Vendimit nr. 84, datë 26.12.2013 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.83, Datë 26/12/2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”, si dhe në studimin e tregut që Komisioni i Strehimit ka bërë për vlerën e qirasë për vitin 2024, i kërkojmë Këshillit Bashkiak të,

VENDOSË:

1.Miratimin e listës së familjeve të pastreha në Bashkinë Klos, për efekt subvencionimi qiraje, për vitin 2024 sipas listës bashkëlidhur.

P/ Sek. të Kujdesit Social, Ndhmës Ekonomike,
Strehimit Social, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut

Sanije Gjini

Zv/kryetari i Bashkisë
Adelina Laçi

KRYETARI I BASHKISË

Valbona KOLA



RELACION

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT "SUBVENCIONI I QIRASË"

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social", kreu V neni 33, 34, 35, 38, 39, dhe të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësisve të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin" ju informojmë se;

Në mbështetje të nenit 24 të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" parashikohet se Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ligji nr. 22/2018, "Për strehimin social", ka për objekt të tij administrimin dhe shpërndarjen së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim, si dhe referuar nenit 15, pika 5 të po këtij ligji përcaktohet se lista e përfituesve dhe dokumentacioni përkatës për përftimin nga programi i bonusit të strehimit vlerësohet nga komisioni i strehimit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Me vendimin nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", janë për caktuar dokumentacioni dhe procedurat me qëllim përftimin e programeve sociale të strehimit.

Një nga format e trajtimit me strehim të familjeve në nevojë është dhënia e subvencionit të qirasë në tregun e lirë,

Subvencionimi i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë së tregut të lirë.

Subvencioni i qirasë për banesat bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, kur nuk kanë fond të lirë banesash sociale me qira, si rregull kur:

1. Nuk zotërojnë fonde për investime të reja, ose blerje banesash në treg,
2. Ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm se subvencioni i qirasë,

3. Familja është në kushtet e emergjencës për strehim dhe nuk përfiton nga asnjë program tjetër.

Kategoritë që kanë përparësi në subvencionimin e qirasë sipas nenit 34 te ligjit 22/2018 janë :

1. Individët me statusin e jetimit
2. Personat me aftësi të kufizuar
3. Të moshuarit
4. Invalidët e punës
5. Familjet e policëve të rënë në detyrë
6. Emigrantët e rikthyer
7. Punëtori emigrant
8. Azilkërkuesit
9. Familjet e komunitetit rom
10. Familjet e komunitetit egjiptian
11. Viktimat e dhunës në familje
12. Viktimat e trafikimit
13. Prindërit e vetëm që kanë në ngarkim fëmijë
14. Individët që i përkasin komunitetit LGBTI,
15. Të miturit 14-18 vjeç dhetë rinjtë 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin
16. Vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave të specializuara
17. Familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas Aktit normativ nr.3 datë 1.3.2012

Subvencioni i qirasë iu shpërndahet me vendim të Këshillit Bashkiak, atyre familjeve të cilat kanë paraqitur kërkesën për strehim duke plotësuar formularin tip, dhe dorëzimin e dokumentacionit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore të strehimit.

Në Bashkinë Klos, njoftimi për fillimin e aplikimeve për të përfituar subvencionin e qirasë për vitin 2024 i shoqëruar me informacion të hollësishëm, është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë në muajin janar 2024.

Po kështu kontaktet e përditshme pranë sektorit tonë me aplikantët, familje dhe individë të interesuar, kanë shërbyer për dhënien e informacionit të nevojshëm për objektin e këtij projekti, kushtet dhe kriteret, dokumentacioni i nevojshëm, kategoritë që trajtohen me përparësi etj. Aplikimet dhe paraqitja e dokumentacionit është bërë pranë sportelit të Zyrës me Një Ndalesë dhe më pas janë depozituar pranë sektorit të Kujdesit Social, Ndhimës Ekonomike, Strehimit Social, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut. Ky sektor i paraqiti Komisionit të Strehimit Social të ngritur me Urdhër të Kryetarit Nr.14, datë 23.01.2024 “Për ngritjen e komisionit të strehimit social”, të gjitha Kërkesat për subvencionimin e qirasë të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit.

Komisioni i Strehimit të Bashkisë, mori në shqyrtim të gjitha kërkesat së bashku me dokumentacionin e paraqitur.

Bazuar në dokumentacionin përkatës të çdo aplikanti, në rezultatet e verifikimit në terren të banesave dhe të kushteve të banimit, bazuar në aktet ligjore në fuqi për përcaktimin e masës së subvencionimit,

Komisioni i Strehimit miratoi;

1. Familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë së tregut të lirë dhe masën e subvencionit rast pas rasti.
2. Skualifikimin e familjeve, që nuk plotësonin kushtet, ose kishin mungesë të të dhënave për anëtarët e tjerë të familjes.

Bashkëlidhur këtij projekt-vendimi paraqesim listën me emrat e aplikantëve dhe masën e subvencionit që përfitojnë.

**P/ Sek. të Kujdesit Social, Ndhmës Ekonomike,
Strehimit Social, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut**

P/ Sanije Gjini


**Zv/kryetari i Bashkisë
Adelina Laçi**

